



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VORË
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM Nr.58

Datë 24/12/2024

**‘ MBI MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFAT-MESËM 2025-2027
DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË VORË PËR VITIN 2025’**

Këshilli Bashkiak Vorë i mbledhur sot më datë 24/12/2024 Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b”, pika 1.3 shkronja “c” nenit 41, pika 1, neni 54, shkronjat “ç” dhe “dh”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr.7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 6, shkronjat “ç” dhe “d”, nenit 33, pika 1, nenit 39, pika 1, nenit 40, nenit 41, pika 1 dhe 3 të ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neneve 6, 15, 17 dhe 32, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, nenit 2, shkronja “c” dhe nenit 5, shkronjat “a” dhe “d” të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, pikës 17, të vendimit nr.165, datë 02.03.2016, të Këshillit të Ministrave “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, udhëzimit nr.8 datë 28.02.2022, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024 - 2026”, udhëzimit plotësues nr.23 datë 08.07.2022, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026”, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak Vorë ;

V E N D O S I :

1. Miratimin e Programit Buxhetor 2025-2027 dhe Detajimin e Buxheti të Bashkisë Vorë për vitin 2025 sipas dokumentit bashkëlidhur
2. Të Miratojë numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Vorë 487 (bashkë me Njësitë Administrative Prezë dhe Bërxullë).sipas tabelës bashkëlidhur.



3. Ngarkohet Sektori i Administratës, Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Sektori i Shërbimeve Publike, Sektori i Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Sektori i Financës, Sektori i Taksave dhe Tarifave, Sektori i Bujqësisë, Sektori i Pronave, Sektori Emergjencave Civile dhe Sektori i Ndihmës Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefektura.

KRYETARE E KËSHILLIT

EMIRLANDA ÇELA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VORË

**DREJTORIA MENAXHIMIT FINANCIAR DHE PROGRAMEVE TË
STREHIMIT**

Nr. 6673/1 Prot.

Vorë, më 19.12.2024

Lënda: Relacion për Miratimin e Programit Buxhetor, për vitin 2025 për Bashkinë Vorë.

KËSHILLIT BASHKIAK TË BASHKISË VORË

Paraqesim para Këshillit Bashkiak Projekt Buxhetin për vitin 2025

Ky relacion bazohet në bazën ligjore si vijon:

- **Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;**
- **Ligjin Nr. 68, datë 24.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;**
- **Ligjin Organik i Buxhetit**
 - Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit e buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
 - Ligjin nr.57, datë 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit e buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”;

➤ **Udhëzimet Standarte të Përgatitjes dhe Zbatimit të Buxhetit**

Udhëzimin i Ministrisë së Financave Nr. 7, datë 28.02.2018 “Për Proçedurat Standarte të Përgatitjes së Buxhetit”, si dhe udhëzimin i Ministrisë së Financave Nr. 9, datë 20.03.2018 “Per Procedurat Standarte te Zbatimi te Buxhetit”. Udhëzimin plotësues Nr. 20, datë 10.07.2019 “ Per Përgatitjen e Buxhetit Vendor”.

- Udhëzim Plotësues Nr.1, date 24.01.2024 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2024"

Misioni

Misioni i Bashkisë Vorë është të ndërtojë një buxhet për qytetarin, ku proçesi i planifikimit dhe zbatimit të tij, ka në fokus përdorimin me efikasitet, efektivitet dhe transparencë të burimeve publike. Rritja ekonomike, duke siguruar një nivel optimal të investimeve publike dhe shpërndarjen e burimeve në përputhje me objektivat strategjike, ka përmisuar dhe do të

vazhdojnë të përmissojnë ndjeshëm cilsinë e jetës së qytetarëve dhe klimën e biznesit në qytetin tonë.

✓ **Qëllimi**

Theksojmë se qëllimi i këtij është Buxheti si dokumenti bazë i planifikimit dhe kontrollit të politikave për të gjitha autoritetet vendore, nuk është thjeshtë një përmbledhje shifrash por është një lidhje e fortë midis fondeve në dispozicion, qëllimeve, objektivave dhe politikave të institucionit tonë, të cilat duhet të arrihen brënda vitit buxhetor, ndaj dhe planifikimi i buxhetit është arti i qeverisjes sonë. Bashkia Vorë është munduar të identifikojë nevojat e tanishme dhe të ardhshme të komunitetit dhe të përcaktojë aktivitetet e nevojshme për të përmbushur objektivat strategjik financiar. Buxheti është baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së burimeve për vitin 2025.

Theksojmë se qëllimi i këtij buxheti është prezantimi i strategjive apo politikave të Bashkisë, sipas secilit program, me terma financiar dhe tendencat e mundshme të të ardhurave dhe shpenzimeve, nisur nga situatat aktuale. Gjithashtu paraqitja e një disipline financiare, dmth një buxheti të balancuar duke evidentuar qartë autoritetin përgjegjës për zbatimin e secilit program.

✓ **Objektivat kryesore për buxhetin vendor të Bashkisë Vorë për vitin 2025.**

1. Rritja e autonomisë fiskale.
2. Rritja e kapacitetit të të ardhurave vendore të NJVQV-ve për të përmbushur nevojat financiare për ofrimin e më shumë shërbimeve.
3. Transparenca e mbledhjes së të ardhurave dhe kryerjes së shpenzimeve të fondeve ndaj komunitetit, si qeverisja më e afërt me qytetarët.
4. Përmirësimi i qëndrueshmërisë, thjeshtësisë dhe barazisë në sistemin e transfertave, së bashku me rritjen e transparencës.
5. Përmirësimi i sistemit të administrimit të financave publike në nivel vendor.
6. Përmirësimi i procesit të planifikimit, hartimit dhe zbatimit të buxhetit.
7. Financime të integruara sipas instrumentit të Politikës së Zhvillimit Rajonal, duke siguruar transparencë dhe efikasitet në shpërndarje, si dhe bashkërendim me objektivat kombëtarë.
8. Konsolidimi i funksioneve të reja të transferuara në njësitë e qeverisjes vendore.
9. Në vitin 2025, do të zhvillohen edhe politika të cilat synojnë rritjen e performancës së burimeve njerëzore në nivel vendor.

1	Paga Rrjeti Rrugor Rural	00	01	04520	600	9999999	531,480		531,480
2	Sigurime Shoqërore Rrjeti Rrugor Rural	00	01	04520	601	9999999	88,683		88,683
3	Objekte e materiale investimi ne rruge	00	01	04520	231			2,373,984	2,373,984
4	Rikonstruksion i Rrugës Industriale pranë Terminalit të Doganës së Tiranës; Bashkia Vorë	00	01	04520	231			5,000,000	5,000,000
5	Sistemim, Asfaltim Rrugëve hashnjët Hakëve dhe Tafëve, Njësia Administrative Bërçullë, Bashkia Vorë	00	01	04520	231			14,627,403	14,627,403
6	Sistemim Rikonstruksion i Rrugeve te brendshme Lagje e re Loti 1+2	00	01	04520	231			5,000,000	5,000,000
7	Sistemim, Asfaltim, Rikonstruksion segmenti Ruga Shehlerve - Rruga Kodër Bërçullë	00	01	04520	231			6,732,800	6,732,800
8	Sistemim - Asfaltim i Rrugëve Domje, Rruga Ramadan Zazkocki + Rruga Kodra e Totëve, Rruga Ismail Qemali, Rruga Naim Frashëri, Njësia Administrative Bërçullë, Bashkia Vorë	00	01	04520	231		-	10,000,000	10,000,000
9	Sistemim - Asfaltim i Rrugës I Qershori, Njësia Administrative Bërçullë, Domje, Bashkia Vorë	00	01	04520	231			5,000,000	5,000,000
10	Mbikqyrje e kolaudator te Objekteve dhe kontratave te lidhura	00	01	04520	231			11,417,404	11,417,404
11	Rr. Shehi dhe Liqeni, Pëcar	00	01	04520	231			15,000,000	15,000,000
12	Sistemim, Asfaltim Rruga Lagja e Re Fushe-Preze, Njësia Administrative Preze, Bashkia Vorë	00	01	04520	231			7,674,721	7,674,721
13	Rehabilitimi i Rrugës Ahmetaj (Fondi)	00	01	04520	231			-	-
14	Rikonstruksion i rrugëve Muçaj, Sheraj dhe Veseleve, Fshati Muçaj si Rehabilitim i Rrugës nga Shkollë tek Alvorët, Muçaj (bashkuar)	00	01	04520	231			22,604,841	22,604,841
15	Rikonstruksion i rrugëve për Investimin e Banesave Sociale nga Katari	00	01	04520	231			-	-
16	Garanci punimi për Asfaltimi i Rrugës Fshatit Palaj	00	01	04520	231			600,000	600,000
17	Ndërtim për permirsimine shtresave te asfaltit (rruga nga Lapidari përfshi dhe Varrezat)	00	01	04520	231		20,000,000	-	20,000,000
18	Riparime të rrugëve të Njësise Administrative Prezë	00	01	04520	231		-	10,000,000	10,000,000
19	Riparim i rrugës dhe Ndërtimi i murit mbajtës Njësia Administrative Bërçullë-Domje.	00	01	04520	231		-	15,000,000	15,000,000
TOTALI VII							20,620,163	131,031,153	151,651,316
1	Pagat Planifikimi Urban Vendor	00		06140	600	9999999	6,900,000	5,100,000	12,000,000
2	Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore Planifikimi Urban Vendor	00		06140	601	9999999	1,200,300	803,700	2,004,000
3	Hartim Projekte investime për Bashkinë Vorë			06140	230	9999999		3,000,000	3,000,000
TOTALI IX							8,100,300	8,903,700	17,004,000
1	Furnizim Vendasje e Linjës së Ujësjellës në Rrugën e Fshatit Kodër Bërçullë	00		06370	231	1650166		2,000,000	2,000,000
2	Shtesë i Rrugës I Qershori, Njësia Administrative Bërçullë, Domje, Bashkia Vorë	00		06370	231	1650171		6,676,608	6,676,608
3	Ndërtim i Rrjetit KUZ Rruga e Vromit Ahmetaj, Njësia Administrative Prezë, Bashkia Vorë	00		06370	231	1650153		20,646,611	20,646,611
4	Riparim i vazhdimt të Kolektorit të Fshatit Bërçullë, Bashkia Vorë	00		06370	231			10,000,000	10,000,000
TOTALI XI								39,323,219	39,323,219
1	Sport dhe Argëtim	00		08130	604	9999999	-	30,000,000	30,000,000
2	Sistemim i Fushës sportive Ahmetaj (Rikonstruksion i Bazamentit dhe rrethimi)	00		08130	231	1650174		5,000,000	5,000,000
3	Stadiumi							1,000,000	1,000,000
4	Ndërtim i Tribunës kryesore të Stadiumit Vorë							20,000,000	20,000,000
TOTALI XII								56,000,000	56,000,000
1	Paga Arsimit Bazë dhe Parashkollor	00		09120	600	9999999	54,000,000		54,000,000
2	Sigurimet Shoqërore	00		09120	601	9999999	8,000,000		8,000,000
3	Shpenzime Operative	00		09120	602	9999999	6,861,120	23,989,433	30,850,553
4	Rikonstruksion i Shkollës 9-vjeçare Fshati Muçaj, Bashkia Vorë	00		09120	231	1650093		17,000,000	17,000,000
5	Ndërtim i Kopshët Vorë	00		09120	231	94902AD		-	-
6	Ndërtim i Shkollës 9-vjeçare Fshati Pëcar, Bashkia Vorë	00		09120	231			-	-
7	Mbikqyrje punimeve për Objektivin "Ndërtim i Kopshët Publik Vorë "Bashkia Vorë	00		09120	231			1,114,929	1,114,929
8	Kolaudim punimeve për Objektivin "Ndërtim i Kopshët Publik Vorë "Bashkia Vorë	00		09120	231			133,792	133,792
9	Riparim dhe sistemim i terreneve sportive te shkolles 9 - vjeçare Prezë	00		09120	231			10,000,000	10,000,000
TOTALI XIII							68,861,120	52,238,154	121,099,274
1	Paga Arsimit i Mesëm i Përgjithshëm	00		09230	600	9999999	5,464,577	-	5,464,577
2	Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore	00		09230	601	9999999	845,558		845,558
3	Shpenzime për shërbime Pensioni Punonjësish	00		09230	606	9999999	-		-
5	Rikonstruksion i plotë dhe shtesë e Shkollës së Mesme "Vajdin Lamaj", Domje, Bashkia Vorë	00		09230	231	1650159		1,613,518	1,613,518
6	Ndërtim i Shkollës "ISA BOLETINI"	00		09230	231			-	-
TOTALI XIV							6,310,135	1,613,518	7,923,653
1	Fondi Rezervë	00		04980	609	9999999		8,355,800	8,355,800
TOTALI XV								8,355,800	8,355,800
1	Fondi Kontigjencë	00		04940	602	9999999		8,205,000	8,205,000
TOTALI XVI								8,205,000	8,205,000
1	Menaxhimi i mbetjeve Urbane(Transport për në Lanfill)	00		05100	602	9999999	25,571,192	-	25,571,192
TOTALI XVII							25,571,192		25,571,192
1	Bonus qera nga te ardhurat	00		10661	606	9999999		2,000,000	2,000,000
TOTALI XVIII								2,000,000	2,000,000
SHUMA Transfete+Të Ardhura + Specifike (01+05)							382,198,463	700,082,250	1,082,280,713
	600						246,005,615	143,494,367	389,499,982
	601						41,183,943	22,552,750	63,736,693
	602+606+609						55,008,905	245,616,538	300,625,443
	231						40,000,000	288,418,595	328,418,595
SHUMA Transfete+Të Ardhura + Specifike (01+05)							382,198,463	700,082,250	1,082,280,713

✓ **Prioritet i Programit Buxhetor për vitin 2025**

Prioritetet e buxhetit të Bashkisë Vorë për vitin 2025 mbështeten në kërkesat e qytetarëve të Vorës dhe në Programin e Kryetarit të Bashkisë. Shtyllat kryesore në të cilat është mbështetur hartimi i buxhetit për vitin 2025 janë pikërisht këto synime:

- Rritja e cilësisë së jetës
 - Rritja e shanseve për punësim
 - Zhvillimi ekonomik i bashkisë Vorë
 - Zhvillimi infrastrukturës për biznesin
 - Përkrahje sociale
 - Investime në rrugë
 - Investime në infrastrukturën arsimore
 - Zhvillimi i aktiviteteve kulturore dhe sportive.
- Si përfundim mund të themi që kemi një Buxhet të Balancuar i cili pasqyron më së miri priroritetet e një Qeverisje Vendore efektive, efëiente dhe në shpërbim të komunitetit.

PËRGJ. FINANCE

Lulzime Sulaj



DREJTORI I FINANCËS

Aida DEDJA



KRYETAR

Blerim SHERA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT TIRANË
SEKTORI JURIDIK



Nr. 231 Prot.

Tiranë më 16 . 1 .2025

Lënda: Verifikim ligjshmërie

KËSHILLIT TË BASHKISË VORË

Bazuar në ligjin nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut“, i ndryshuar dhe ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore “ i ndryshuar, Prefekti i Qarkut Tiranë, verifikoi Vendimet nr. 57-59, datë 24.12.2024 të Këshillit të Bashkisë Vorë.

Vendimi nr.57, datë. 24.12.2024 “Për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë Vorë për vitin 2025“,

Konfirmohet referuar ligjit nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“ i ndryshuar dhe Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006“ Për sistemin e taksave vendore“, i ndryshuar.

Vendimi nr.58, datë 24.12.2024 “Mbi miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Vorë për vitin 2025“,

Konfirmohet referuar Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 „Për menaxhimin e sistemit buxhetor, i ndryshuar, si dhe Ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Vendimi nr.59, datë 24.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të programit programit buxhetor afatmesëm 2026-2028“,

Konfirmohet referuar ligjit nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“ i ndryshuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKT

AFRIM QËNDRO